AROMË KUJTESE

Revistë shkollore



Prishtinë, 2024

BOTUES:

GJIMNAZI I SHKENCAVE NATYRORE “SAMI FRASHËRI”

KRYEREDAKTOR:

Arbenita Vokshi Dobruna

REDAKTOR GJUHËSOR:

Adriatik Zeqiri

ARTI GRAFIK:

Nart Aliti

SHTYPSHKRONJA:

Blendi

Të dashur lexues,

Është një kënaqësi e veçantë për mua të paraqes këtë botim të veçantë të revistës sonë shkollore, që mban titullin simbolik "AROMË KUJTESE". Kjo përmbledhje përfaqëson zërin dhe mendimin e gjimnazistëve tanë nga shkolla "Sami Frashëri", të cilët, përmes penës së tyre, kanë reflektuar mbi vizitën në Muzeun "Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova".

Falënderoj nxënësit për përkushtimin e tyre, si dhe mësimdhënësen e lëndës "Trashëgimia kulturore dhe diversiteti kulturor", Arbenita Vokshi Dobruna, që e ka mundësuar këtë iniciativë të mrekullueshme. Uroj që ky botim të shërbejë si një burim frymëzimi për të gjithë ata që e lexojnë dhe një kujtesë për rëndësinë e vlerave tona kombëtare.

Me respekt,

Betim Sylejmani

Drejtori i Gjimnazit të shkencave natyrore "Sami Frashëri"

Me gëzim ju prezantojmë këtë botim të veçantë të revistës sonë shkollore, i cili përmban krijimet e nxënësve bazuar në vizitën e tyre frymëzuese në Muzeun "Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova".

Kjo përvojë unike jo vetëm që i njohu nxënësit me momente kyçe të historisë sonë kombëtare, por gjithashtu i frymëzoi ata të reflektojnë mbi vlerat e lirisë, sakrificës dhe identitetit tonë kombëtar.
Në këto faqe do të gjeni ese që pasqyrojnë emocionet, mendimet dhe përshtypjet që kjo vizitë u ka lënë nxënësve. Përmes rrëfimeve të tyre, ata kanë sjellë jo vetëm kujtime nga muzeu, por edhe mesazhe për të ardhmen – një thirrje për të ruajtur dhe vlerësuar trashëgiminë tonë kombëtare.
Kjo revistë është një homazh ndaj atyre që dhanë gjithçka për pavarësinë tonë dhe një tregues se si brezi i ri e ndjen dhe e përqafon historinë e tij. Shpresojmë që çdo lexues të gjejë frymëzim dhe krenari teksa ndjek këto rrëfime të sinqerta dhe të ndjera.

Ju ftojmë ta lexoni këtë botim me mendje të hapur dhe zemër të ngrohtë, të shijoni këto krijime dhe të ndjeni emocionet e këtij udhëtimi përmes syve dhe fjalëve të nxënësve tanë.

Arbenita Vokshi Dobruna

Mësimdhënëse e lëndës "Trashëgimia kulturore dhe diversitet kulturor"

Një komb që nuk mëson nga e kaluara, nuk mund të ndërtojë një të ardhme!

Sami FRASHËRI

Nëse do të mbjellësh për një vit,

mbill misër e grurë.

Nëse kërkon që të mbjellësh përgjithmonë,

mbill arsim e kulturë!

Sami FRASHËRI



VIZITË NË MUZE



Të vizitosh vende të cilat tregojnë hapat e zhvillimit dhe vlerat e vendit tonë, është një ndjenjë mjaft e veçantë. Kjo ndjenjë më kaploi kur hyra në Muzeun "Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova".

Teksa ciceroni tregonte se çfarë domethënie kanë fotografitë e vendosura në muret e objektit, përveç se mësoja më shumë për vendin tim, kuptova se sa me fat jam që jam banore e tij.

Muzeu, me gjithsej 84m², i është dedikuar Pavarësisë së Kosovës. Në vitin 1988, objekti shërbeu si zyrë e Kosova Film-it, në të njëjtin vit u hyri në punë edhe Shoqatës së Shkrimtarëve, ku u zgjodh kryetar ish-presidenti Rugova. Pas një viti, 1989 shërbeu si vend i krijimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku edhe këtu u zgjodh lider Ibrahim Rugova. Në vitin 1999, objekti digjet nga forcat serbe. Siç shohim, vlerat e muzeut sa shkojnë e rriten, për shkak të shërbimeve të shumta që ai ka kryer në të kaluarën.

Në muret e muzeut tregohen fotografitë me ngjarjet si: jeta e ish-presidentit Rugova, ajo private dhe publike, ngjarjet e viteve të 90-ta, pajtimi i gjaqeve, helmimi i nxënësve të shkollave të Kosovës, marrja e të vetmit televizion që Kosova kishte në atë kohë, themelimi i partive, dalja e qytetarëve në referendum (1991), zgjedhjet presidenciale (në këto zgjedhje bëhet edhe "Dita e Presidentit" që festohet në çdo 24 maj), rrahjet, dhuna dhe maltretimet e serbëve ndaj popullit të Kosovës, shpërngulja me dhunë e qytetarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre, shëndetësia dhe arsimimi, parlamentet, dalja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në skenë, çlirimi dhe kthimi i qytetarëve të Kosovës në vendlindje.

Këto ngjarje lanë gjurmë të mëdha në shtetin tonë, pati dëmtime të mëdha shpirtërore, ekonomike e shëndetësore.

Në muze tregohen edhe ngjarjet e ndodhura në Kosovën pas luftës, të cilat vlen të ceken: administrata e UNMIK-ut. zgjedhjet e bëra pas vitit 1999, vdekja e ish presidentit Rugova (lamtumira e fundit) 2006 dhe më e rëndësishmja që vulosi çdo sakrificë të bërë për këtë vend, e cila është shpallja e Pavarësisë së Kosovës nga ish kryeministri Hashim Thaçi, më 17 shkurt 2008, në orën 15:39, ku Kosova u shpall vend i lirë, i pavarur dhe demokratik.
Vizita në muze ishte përvojë mahnitëse. Çdo figurë tregonte qartë historinë e vendit tim të bukur.

Enea UKA

SHTËPIA E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës është një vend me rëndësi të madhe historike që ka një ndërlidhje me ish- presidentin Ibrahim Rugova dhe gjithashtu procesin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.
Ky vend është i njohur për rolin e tij gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Ishte një konflikt i armatosur që shënoi kulmin e dhunës dhe torturave njëkohësisht dhe përpjekjeve për pavarësinë e Kosovës. Ku vlen të përmendet dhe helmimi i studentëve si një ngjarje tragjike në mënyrë që të ndëshkonin dhe shkatërronin popullatën shqiptare dhe mundësinë e krijimit të një shoqërie demokratike dhe të pavarur, e duke përfshirë masakrat, vrasjet, të zhdukurit, dhunimet, shkatërrimin e shtëpive dhe objekteve civile, spastrimin etnik etj.
Rugova ishte një figurë kyçe, i cili udhëhiqte gjatë periudhës së rezistencës paqësore, duke mbrojtur parimet e një shoqërie demokratike.
Shtëpia e Pavarësisë është një vend ku janë zhvilluar takime të rëndësishme politike dhe historike për procesin e pavarësisë së Kosovës. Ajo është simbol i angazhimit të ish- Presidentit Rugova për arritjen e një shteti të pavarur dhe të qëndrueshëm për popullin e Kosovës.
Disa ngjarje që lidhen me Shtëpinë e Pavarësisë janë: mbledhja e udhëheqësve të Kosovës për pavarësi 1989-1990, lufta paqësore dhe përpjekjet ndërkombëtare, takimet e Rugovës dhe udhëheqësve të Kosovës, Deklarata e Pavarësisë 2008.
Sot, kjo shtëpi është një muze ku vizitorët mund të shohin dokumente dhe foto që tregojnë historinë e Kosovës dhe angazhimin e Rugovës për një të ardhme të pavarur dhe të lirë.

Lejla DURMISHI

BAC, U KRY!

Ishte pikërisht egoja e okupatorit tonë; pikënisja e çdo gjëje, pikënisja e okupimit dhe më pas e luftës. Por gjithmonë e ndjekur pas nga nënvlerësimi i tyre, që ishte arma më e fortë e popullit tonë pasi që qëndruam stoik duke u bashkuar dhe krijuar "Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", e cila filloi ndërveprimet, që me shfaqjen e parë publike më 28 nëntor 1997 me Rexhep Selimin, Daut Haradinaj dhe Mujë Krasniqin. Ishte një hap fillestar për një rrugëtim të pa shmangshëm për liri.

Të bëmat e pa mohueshme të UÇK-së kremtohen sot e kësaj dite, ku imagjinata është e pa dobishme kur mundohemi të parafytyrojmë sakrificat, të cilat sypatrembur trimat e mëmëdheut tonë i realizuan vetëm se ne sot të gëzojmë këtë liri të shenjtë. Dashuria për liri, ndjenja për ardhmëri, etja për pavarësi, qëndrueshmëria për drejtësi mund të themi lirshëm se janë kryeqendër e definicionit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Adrenalina krahas trimërisë është një eksperiencë e pa mohueshme e trimave të mëmëdheut tonë. Ishte pikërisht edukata familjare, e cila në popullin tonë filloi duke u pasuar gjeneratë pas gjenerate dhe duke u bazuar në kanun, që ishte një ligj i jetesës, ku kombi ishte gjëja më e shtrenjtë dhe e pathyeshme për ty si individ, pasi që me të lind dhe nuk e zgjedh krahas çdo gjëje që ndryshon.

Prandaj, UÇK-ja si vetëtimë po vepronte, që kufirin mes trojeve shqiptare okupatori të mos e kushtëzonte. Ishin ato vitet më të zymta shqiptare '98 dhe '99 ishte një gjendje tmerruese se si një rutinë ditore, gjakun për toke e normalizonte, masakër pas masakre, plumb pas plumbi, altruist e dëshmor pas dëshmori. T'i themi të ëmës, cilin lajm do të merrte më parë: atë të mirë apo atë të keq? Sepse biri yt, që me mund e rrite njëherë si vogëlush e sot si trim e përgatite për ushtri lirinë me gjakun e tij na e premtoi, ai vetë nuk i mbijetoi që me ne ta gëzonte.



Mallëngjyese ishte se si humanizmi nuk ekzistonte tek armiku vetëm për vetëm ushqimi për ego se si të korrte një fitore. Ne, ndoshta, në ndonjë betejë u dobësuam, por natyrisht se luftën në fund e kemi fituar. Amanetin e komandantit deri në fund e quan dhe gjakun e tij dhe të 56 anëtarëve të tjerë e ndriçuan. Pasi që ndërgjegjja e pastër nuk do të lejonte se si pasardhësit, nën frymën e heroizmit të mos evoluonin. 5, 6 dhe 7 marsi të vitit '98 ishin

një acar i papërshkrueshëm për gjithë ne, shqiptarët se si Prekazi shkatërrimin e shpresave po përjetonte, por qëndrueshmërinë për brezi po e mbante, një fund i hidhur u përjetua në ato data, por një zjarr përbrenda çdo ushtari lindi, që në fund u shua me triumf, kur KATANA arriti të thyente kufirin me Brigadën 138 me përfundimin e "Betejës së Kosharës" më 9 prill 1999, e cila fatmirësisht u pasua nga çlirimi i Kosovës, me ndihmën e bombardimeve 78-ditore të NATO-s.
Këtë liri dhe pavarësi që ne gëzojmë sot, është e gjitha falë të bijve të nënave shqiptare, të cilët të gatshëm në çdo kohë pa kursyer as jetën i mbrojtën interesat e shenjta të atdheut, ashtu siç ishin betuar që në pikënisje të këtij rrugëtimi të madhështor, i cili "BAC, U KRY!"

Soraja EJUPI

OPERACIONI PATKOI

Operacioni Patkoi është term që përdoret për të përshkruar një operacion të supozuar të forcave serbe, kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë konfliktit në vitin 1999.
Ky term fillimisht u shfaq në raportet e inteligjencës gjermane dhe më vonë u përhap në mediat perëndimore ku u pretendua se forcat serbe kishin planifikuar një fushatë të organizuar për të dëbuar shqiptarët e Kosovës nga shtëpitë e tyre, si pjesë e një operacioni sistematik spastrimi etnik. Operacioni u përshkrua si një përpjekje për të formuar një "patkua" përreth Kosovës duke i shtyrë shqiptarët e Kosovës në Shqipëri dhe në kufijtë e Maqedonisë. Sipas disa burimeve, ky plan përfshinte djegien e fshatrave shqiptare, shkatërrimin e pasurive dhe zhvendosjen masive të popullsisë.
Qeveria serbe e asaj kohe e mohoi ekzistencën e një operacioni të tillë, duke e quajtur atë propagandë të NATO-s për të justifikuar ndërhyrjen ushtarake. Ky operacion mbetet një temë e debatueshme dhe me interpretime të ndryshme.

Neritan RAMADANI

PAJTIMI I GJAQEVE – FILLIMI I NJË EPOKE TË RE NË HISTORINË KOSOVARE

Ky shkrim shtjellon historinë e një populli, i cili për shekuj me radhë është munduar të arrijë unifikim territoresh, idesh e besimesh. Kanuni i Lekë Dukagjinit është parë si "arma" më ideale, përmes ligjeve me dominim më shumë ato tradicionale, që të konsolidohet vendimmarrja dhe mënyra e jetesës, përbrenda popullit shqiptar, më në fokus midis dy besimeve kryesore, asaj myslimane dhe krishtere.

I përbërë nga 1262 artikuj, në masë të shtuar që nga viti 1900, ky kodifikim ligjesh modifikoi jetën ekonomike, mikpritjen, vëllazërinë, kufijtë, punën, martesën e ndarjen e tokës. Dy pikat më kyçe janë konsideruar të jenë ruajtja e nderit dhe e besës.

Ligji më kontrovers ka qenë ai i gjakmarrjes, ku në këso situata, zgjidhja e vetme e paraparë është menduar të jetë ajo që njihet si "koka për kokë", që nënkupton se në rast vrasjeje, dhunimi, apo çfarëdo forme të prishjes së nderit, duhet marrë jeta e personit (apo një mashkulli të familjes) që ka kryer krimin.

Kjo situatë hakmarrjeje, ka qenë një plagë tejet e dhimbshme, që ka degraduar deri në atë masë ku konfliktet më të vogla, kanë çuar në armiqësi të përgjakshme. Familje të shumta janë detyruar të izolohen, të migrojnë, të zhdukin gjurmët e tyre, që mos të humbasin më të dashurit e tyre.

Me theks të veçantë Kosova, në një periudhë kritike, dhe në pikun e spastrimit etnik nga regjimi i atëhershëm, duhej reagim imediat, për bashkimin e popullatës, dhe çrrënjosjen njëherë e përgjithmonë të fenomenit të gjakmarrjes, duke ndalur armiqësinë dhe hovin e frikshëm të vrasjes brenda një kombi.

2 Shkurti i vitit 1990, njihet si periudhë e rishkrimit të historisë,ku një grup studentësh asokohe,më në krye folkloristin dhe profesorin e çmuar, Anton Çetta dhe një grup intelektualësh nga Instituti Albanologjik, nisën aksionin mbarëkombëtarë të pajtimit të gjaqeve, duke sjellë një frymë të re dashurie, solidariteti, dhembshurie, humanizmi e fisnikërie midis një populli që po shtrinte dorën e pajtimit, për hir të vëllazërisë e për hir të atdheut.

Aksioni mori përmasa madhështore në mbarë vendin, si në Kaçanik e Lug të Drinit, Rrafsh të Dukagjinit, në Shalë e në Karadak, në Llap, Drenicë e Gollak, në Has, Rekë, Podrime, Lapushë, Podgur e Rugovë, Rrafsh të Kosovës dhe kudo, ku të rinj e pleq, pa dallim, marshonin pas atyre udhëheqësve, duke simbolizuar një nismë të re paqeje e atdhedashurie. Madhështia e organizimit

kulmoi në Maj të vitit 1990, në hapësirën e njohur si "Verrat e Llukës" ku me një pjesëmarrje prej 500.000 mijë personave (jo të dokumentuar), u pajtuan me qindra raste armiqësie.


Në vitin 1990 është menduar që 1/3 e popullatës ishte në gjakmarrje dhe përbrenda dy viteve, arritën të përmbylleshin 1200 raste dhe në vitin 1993 është raportuar të mos ketë më familje që kishin hatërmbetje.

Aksioni mbarëkombëtar i Pajtimit të Gjaqeve, solli revolucionin e shumëpritur brenda popullit shqiptar, duke thyer barrierën e hekurt të krenarisë dhe duke rrënjosur dashurinë për njëri-tjetrin e mbi të gjitha për atdheun.

Emira AHMETI

FOTO SI KUJTIM

Ky muze prestigjioz mban historinë e horrorit që kanë ushtruar populli serb mbi shqiptarët. Këtu janë të dokumentuara shumë ngjarje katastrofike dhe të tmerrshme të cilat u munduan t'i fshehin me propagandë dhe mashtrim populli serb. Një nga këto raste ishte kur një grua kishte dalë me tre fëmijët e saj dhe një gazetar i kishte dhënë gruas një armë zjarri dhe kishte bërë një histori të pavërtetë se ajo kishte dalë e armatosur nga frika prej shqiptarëve të egër, por si edhe shumë histori propagandistike tjera edhe kjo është dalë e pavërtetë.



Kjo ndërtesë ishte djegur më parë dhe e vetmja mbetje prej djegies së saj ishte një foto e Ibrahim Rugovës me Anton Çetën.

Erin EMRULLAHU

NJË GUR I ÇMUAR

Muzeu i Shtëpisë së Pavarësisë "Dr. Ibrahim Rugova", i njohur më parë si vendi ku e kishte zyrën ish- presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, ka një domethënie të thellë historike dhe kulturore për popullin shqiptar të Kosovës. Ky vend është epiqendra e vendosmërisë dhe rezistencës paqësore që Rugova udhëhoqi për vite të tëra në përpjekje për të çliruar Kosovën.

Rugova e përdorte këtë shtëpi për të pritur diplomatë ndërkombëtarë, aktivistë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, ku këtyre personave ua dhuronte nga një gur si dhuratë, për tu treguar pasurinë nëntokësore të Kosovës. Këta gurë Rugova i kishte mbledhur vetë nga njerëz prej gjithë Kosovës dhe i shndërroi në simbol të saj. Djegja e shtëpisë ishte një synim i serbëve që të zhdukin simbolin e rezistencës dhe të mbillnin frikë te populli, por përkundër përpjekjeve të tyre historia dhe vendosmëria e popullit Kosovar nuk u shuan.

Pas luftës dhe shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 2008, ndërtesa u rindërtua dhe sot funksionon si muze.

Olt RUDARI



MUZEU “HOUSE OF INDEPENDENCE OF KOSOVO”

Ky muze është një nga vendet më të rëndësishme që pasqyron periudhën e luftës për çlirim dhe pavarësi të Kosovës, si dhe figurat kyçe të kësaj periudhe.

Muzeu është i vendosur në qytetin e Prishtinës dhe është një nga pikat më të rëndësishme e vizitave për ata që dëshirojnë të kuptojnë më shumë për historinë moderne të Kosovës.

Ibrahim Rugova ishte një nga figurat kryesore që udhëhoqën popullin e Kosovës gjatë periudhës së vështirë të viteve 1990, kur Kosova ishte nën pushtimin e Serbisë, si dhe gjatë periudhës së pasluftës.

Në muze, vizitorët mund të shohin ekspozita të ndryshme që pasqyrojnë jetën dhe veprën e Dr. Ibrahim Rugovës.

- Fotografi historike dhe dokumente që dokumentojnë aktivitetin e Rugovës gjatë luftës së fundit në Kosovë.
- Objekte personale të Dr. Ibrahim Rugovës, gjëra personale si libra, letra dhe objekte që i kanë shërbyer atij gjatë periudhës si lider.
- Artikuj nga periudha e pasluftës- pjesë të ekspozitës që përfshijnë materialet që lidhen me periudhën e pasluftës, si dhe angazhimin e Rugovës për krijimin e institucioneve të Kosovës së Pavarur.

Rion BASHOLLI



FLAMURI DARDAN



Shtëpia e Pavarësisë "Dr. Ibrahim Rugova", ishte vendi ku u bë shtetësia. Ky muze tërheq interesimin e shumë vizitorëve në Prishtinë. Është një shtëpi me hapësirë të vogël, por në të u zhvilluan shumë ngjarje të mëdha drejt rrugëtimit të Pavarësisë së Kosovës. Shtëpia u dogj dhe u shkatërrua gjatë sulmeve serbe.

Në zyrën e Dr. Ibrahim Rugovës, ndër të tjerë bien në sy tre flamuj, i pari ai i Kosovës, i dyti flamuri kuq e zi dhe i treti flamuri dardan që Ibrahim Rugova e kishte dizajnuar vetë. Pas riparimit të objektit, në muze ishin kthyer disa eksponate e fotografi të takimeve të ish- presidentit Rugova me personalitete të ndryshme, dy gurë-simbole, një Kristal Trepçe etj.

Në këtë muze ka pasur shumë aktivitete dhe shumë vendime të rëndësishme. Kështu nga një zyre e shtëpi e vogël ideoheshin dhe kaliteshin ideale dhe projekte të mëdha që kulmuan në pavarësinë e shtetit tonë.

Dion RUSINOVCI



MUZEU- PASURI KULTURORE

Populli ynë shqiptar ka një histori tejet të gjerë. Gjatë kësaj historie njohëm shumë figura të rëndësishme e njëri nga ata mund të konsiderohet Dr. Ibrahim Rugova.

Shtëpia e Pavarësisë është një objekt i cili i kushtohet figurës historike Dr. Ibrahim Rugova, por njëkohësisht historisë së shqiptarëve që nga vitet e 90-ta.

Gjatë kësaj kohe përfshihen ngjarje të shumta, të rëndësishme si:

1989-1990 – Fillimi i rritjes së nacionalizmit serb dhe shtypja e autonomisë së Kosovës nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit;

1998-1999 - Lufta e Kosovës dhe përpjekjet e Rugovës për të gjetur një zgjidhje paqësore dhe diplomatike për krizën.

Pas 1999 – Periudha e pasluftës dhe kontributi i Rugovës në rindërtimin politik dhe institucional të Kosovës deri në shpalljen e Pavarësisë më 17 shkurt 2008.

Të kemi këtë shtëpi-muze është një pasuri e madhe kulturore që jo të gjitha vendet e gëzojnë. Me një rëndësi të madhe shërben si një vend përkujtimor dhe edukativ që nderon liderin dhe inspiron vizitorët me vlerat dhe idealet për të cilat u përpoq.

Alba ÇERKINI



KOSOVA SI SHTET I PAVARUR

Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008, pas një periudhe të gjatë historike dhe sfidash politike. Deklarata e Pavarësisë u lexua nga ish kryeministri Hashim Thaçi, nën udhëheqjen e ish presidentit Fatmir Sejdiu. Kjo shpallje ishte kulmi i një procesi të gjatë që filloi në fund të viteve 1980 dhe vazhdoi me konfliktin e armatosur dhe ndërhyrjen ndërkombëtare të NATO-s në vitin 1999. Kemi disa pika që çuan në shpalljen e pavarësisë të Kosovës të cilat u përmendën në vizitën e muzeut. Fillimisht kemi :

Prishjen e autonomisë ku kjo rriti ndarjet etnike dhe tensionet politike në rajon;

Lëvizjet paqësore që u udhëhoqën nga Dr. Ibrahim Rugova dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ku shqiptarët e Kosovës ndoqën një strategji paqësore dhe kështu u krijua një qeveri në mërgim dhe një sistem paralel arsimor, shëndetësor dhe ekonomik;

Lufta e Kosovës (1998-1999), kohë gjatë të cilës Ushtria Çlirimtare e Kosovës filloi një kryengritje kundër forcave serbe, kjo shkaktoi një reagim të ashpër të forcave serbe, me krime të rënda kundër popullsisë civile shqiptare, përfshirë spastrimin etnik dhe masakra;

Ndërhyrja e NATO-s;

Pas përfundimit të luftës, Kosova u vu në administrimin e UNMIK-ut dhe mbeti formalisht pjesë e Serbisë, por praktikisht ishte një territor i vetëqeverisur;

Filluan përpjekjet për të ndërtuar institucione shtetërore dhe për të përgatitur një status të përhershëm për Kosovën;

Bisedimet e statusit dhe Plani i Ahtisarit në vitin 2005 të udhëhequra nga i dërguari i posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari. Në vitin 2007, ai propozoi një plan që parashikonte një pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën me masa mbrojtëse për pakicat etnike, sidomos për serbët;

Shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Kosovës si shtet i pavarur dhe demokratik.

Që nga atëherë, Kosova është njohur nga mbi 100 shtete anëtare të OKB-së përfshirë SHBA-të dhe shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, por disa vende, përfshirë Serbinë dhe disa shtete të tjera nuk e kanë njohur ende pavarësinë e saj.

Ana HAZIRI

HISTORIA E NJË POPULLI QË LUFTOI PËR LIRINË E TIJ

Pavarësia e Kosovës është një ngjarje që mbetet e pashlyer në zemrat e çdo kosovari. Për shumë njerëz, ajo është shumë më tepër se një akt politik. Është një simbol i sakrificave, i lotëve dhe shpresës për një jetë më të mirë. Shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 shënoi një hap të madh për popullin shqiptar të Kosovës, një moment që u prit me shumë emocion dhe gëzim, por edhe me shumë dhimbje për të gjithë ata që kishin vuajtur për të arritur deri aty.

Kosova ka kaluar përmes shumë periudhash të vështira, ku çdo brez ka paguar çmimin e tij. Për një kohë të gjatë, shqiptarët e Kosovës jetuan nën kontrollin e shteteve të huaja që i mohuan të drejtën për t'u vetëqeverisur. Populli i Kosovës ka vuajtur nën represion, duke u detyruar të jetojë në kushte të rënda dhe pa liri. Ata nuk kishin mundësi të flisnin lirisht, as të shprehnin identitetin e tyre kulturor. Megjithatë, edhe në këto kushte, ata nuk e humbën besimin dhe as shpresën se një ditë do të ishin të lirë.

Pavarësia e Kosovës është fryt i shumë sakrificave dhe flijimeve. Pas periudhës së pasluftës, kur Kosova ishte e ndarë nga Jugosllavia, gjithçka kishte nisur të duket më e mundshme, por ende ishte shumë larg. Të gjithë ata që luftuan për pavarësinë e Kosovës e bënë këtë jo vetëm për një territor, por për një të drejtë themelore: atë të jetuarit në liri. Ata luftuan për të drejtat e tyre, për mundësinë që brezat që do të vinin pas, të jetonin pa frikë dhe pa shtypje.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) luajti një rol shumë të rëndësishëm gjatë luftës për lirinë e Kosovës. Ushtria e Kosovës nuk ishte vetëm një ushtri luftarake, por një ushtri e njerëzve që donin të mbroheshin nga dhuna dhe persekutimi. Çdo luftëtar kishte një arsye personale për të luftuar. Ata nuk luftuan vetëm për atdheun, por për familjet e tyre, për fëmijët dhe për brezat që do të vinin. Shumë njerëz humbën jetën gjatë luftës. Ata ishin heronj, që dhanë gjithçka për një të ardhme më të mirë. Gjithashtu, shumë njerëz u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë familje u shkatërruan. Këto sakrifica do të kujtohen gjithmonë, sepse ato ishin çmimi i lirisë që Kosova e mori pas luftës. Shpallja e pavarësisë ishte një moment shumë i rëndësishëm për popullin e Kosovës, por ajo nuk do të kishte qenë e mundur pa gjithë ato sakrifica që kishin bërë shumë njerëz gjatë viteve. Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova filloi të ndërtonte një shtet të ri. Ky ishte një moment që mbushte zemrat e të gjithëve me shpresë dhe besim në të ardhmen. Kosovarët e

shihnin pavarësinë jo vetëm si një arritje politike, por si një mundësi për të pasur një jetesë më të mirë, më të drejtë dhe më të barabartë.

Kosovarët luftuan dhe punuan për shumë vite për të fituar atë që e meritojnë: lirinë dhe mundësinë për të krijuar një të ardhme më të ndritur për fëmijët e tyre. Ata arritën ta bëjnë këtë, duke e treguar për herë të fundit se popujt që luftojnë për drejtësinë dhe lirinë, mund të fitojnë.

Megjithatë, pas shpalljes së pavarësisë, sfidat për Kosovën nuk mbaruan. Pavarësia e Kosovës ka ardhur me shumë vështirësi dhe kërkesa. Njohja ndërkombëtare ka qenë një ndër sfidat më të mëdha që ka përballuar Kosova. Disa shtete, përfshirë Serbinë dhe disa shtete të tjera, nuk kanë pranuar ende pavarësinë e Kosovës, duke e bërë të vështirë integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Por, me gjithë këto pengesa, Kosova ka arritur të sigurojë mbështetje nga shumë shtete të tjera, duke përfshirë SHBA-në dhe shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo mbështetje është një shenjë se, pavarësisht pengesave, Kosova është e gatshme të qëndrojë dhe të ecë përpara.

Pavarësia e Kosovës ka një kuptim të madh për gjithë shqiptarët. Ky akt është një mundësi për të forcuar lidhjet mes Kosovës dhe Shqipërisë, dhe gjithashtu për të mbajtur gjallë traditat dhe kulturën shqiptare. Kosovarët, pavarësisht se ku jetojnë, gjithmonë do të kenë një lidhje të fortë me atdheun dhe do të ndjehen krenarë për arritjen e pavarësisë.

Pavarësia e Kosovës është një mësim se asnjëherë nuk duhet të dorëzohesh, pavarësisht sa e vështirë duket situata. Ajo është një frymëzim për çdo komb që dëshiron të arrijë lirinë dhe të drejtën për të jetuar në paqe dhe dinjitet. Kosova ka treguar se, përmes bashkimit dhe sakrificës, çdo popull mund të përballojë çdo sfidë dhe të krijojë një të ardhme më të mirë për brezat që do të vijnë.

Pavarësia e Kosovës është një histori shprese, një kujtim për të gjithë ata që dhanë gjithçka për lirinë e këtij vendi dhe për një të ardhme të ndritur. Ky është një kapitull që do të mbetet i gdhendur në kujtesën e çdo kosovari dhe që do të frymëzojë për shumë vite më tej.

Adena BERISHA

DALJA PUBLIKE E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Për të arritur deri në këtë ditë,që të jemi të pavarur edhe krahas forcave ushtarake, shqiptarët kaluan shumë vështirësi, madje gjatë kësaj rruge pati një sërë humbje jetësh.

Dalja publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është një moment historik i paharrueshëm që lidhet me shpalljen dhe pranimin e saj si forcë e organizuar çlirimtare gjatë luftës në Kosovë në vitet e 90-ta. Ky moment shënoi një kthesë të rëndësishme në përpjekjet për liri dhe pavarësi nga regjimi serb.

UÇK-ja daljen e parë në skenë publike e bëri më 28 Nëntor 1997, ku deklarata për paraqitjen e saj në skenë publike u përgatit nga vetë ushtarët e saj.

Në rast rikujtimi të sakrificave dhe humbjeve të atdhetarëve tanë është ngjarja "Epopeja e UÇK-së" me të cilën ne për 3 ditë radhazi kujtojmë komandantin legjendar Adem Jasharin dhe familjen e tij të cilët u sakrifikuan për lirinë e Kosovës.

Këtë ditë, ne nderojmë edhe të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët të cilët nuk kursyen jetën për të realizuar një ëndërr që është bartur brez pas brezi deri tek ne - Lirinë!

Në këto ditë ne ndjejmë frymëmarrjen e lirë dhe e kujtojmë se sa e rëndësishme ishte për ne lufta çlirimtare, se sa të rëndësishëm ishin për ne ata djem trima që morën armët e nuk pranuan asnjëherë robërinë.

Enea KASTRATI

MUZEU- VLERË KOMBËTARE

Ky muze që është një nga institucionet më të rëndësishme në Prishtinë është një homazh i kontributit të Dr. Ibrahim Rugovës për luftën për liri dhe pavarësi të Kosovës. Muzeu i Ibrahim Rugovës është vendi ku vizitorët mund të njihen me jetën dhe veprën e këtij njeriu të madh. Muzeu në fjalë përmban periudha të ndryshme të Kosovës deri tek periudha e veprimtarisë politike dhe lëvizjes për pavarësi. Dr. Rugova i njohur për qëndrimin e tij të menqur dhe të matur me komunitetet ndërkombëtare përmes diplomacisë udhëhoqi popullin e Kosovës në kohën më të vështirë. Muzeu i Pavarësisë "Dr. Ibrahim Rugova" është testament i respektit dhe nderimit për udhëheqësin që diti të mbrojë interesat e popullit. Ai është vendi ku brezat e ardhshëm mund të mësojnë për vlerat e demokracisë.

Anisa LECI

NDER DHE KRENARI



Hyrja në muzeun "Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova", ishte një ndjenjë e veçantë. Ky muze për dikë mund të jetë thjeshtë disa dhoma të mbushura me fotografi e tekste të ngjarjeve në Kosovë, por të mendosh më thellë, pikërisht aty ku jemi në këtë moment, vite më parë, figura më e ndritur e Kosovës, Ibrahim Rugova, po kryente punët më të rëndësishme të shtetit. Është nderi më i madh të jesh në një vend që sipas meje duhet të konsiderohet vend kyç historik.

Në muze paraqiten ngjarjet historike lidhur me shtetin tonë, që nga dhjetëra vite e deri tash. Është shumë i përshtatshëm për t'u pasuruar në aspektin historik të Kosovës.

Prandaj mendoj se këtij muzeu duhet t'i jepet shumë vëmendje sepse të jem e sinqertë, nuk e dija që ekziston deri më tani edhe pse vizitoj atë rrethinë mjaft shpesh.

Jam falënderuese që tani kam më shumë dije në këtë aspekt pasi që vizitova muzeun!

Stina HALILI



